

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Plarent Ndreca dhe revolucioni i madh i Abetares
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/plarent-ndreca-dhe-revolucioni-i-madh-i-abetares-i474053
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:06:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 19:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	98832bfc88ef2bd6fa4b7fb15d52f3946deb652e3b52821744f0c9e62694966e
TEKSTI	cb917e34045a7428e57255fa8589d946c566a3cd277457529133d2475ba6f4f3
PAMJA	ec86124d9f62d6cb9b65e4c09de7c8c9fcf7c03f07c83325f07999df35570d54

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	224d647cc9d4c979ea220073fb5abad0d15321530bb7559ee1e950304ef1b173
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/224d647cc9d4c979ea220073fb5abad0d15321530bb7559ee1e950304ef1b173>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Plarent Ndreca dhe revolucion i madh i Abetares



13 Shtator 2026, 21:06, Aktualitet CNA



Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër përveç atij që e ka marrë me votë.

Pushteti Gjyqësor.

Dhe tani, me entuziasmin e një fëmije që ka zbuluar një lodër të re, ka vendosur të na shpjegojë Montesquieu-n, Kushtetutën dhe ekuilibrin e pushteteve.



Reforma në Drejtësi "dështoi" kur u shkoi te dera 'Ndregrave'

E lexon shkrimin e tij dhe të krijohet përshtypja se ke përpara një nxënës që ka gjetur një libër me figura dhe ndonjë shënim poshtë tyre, ka nënvizuar disa fjali me laps dhe tani kërkon të bëhet drejtor shkolle.

"KUR PUSHTETI POLITIK ABDIKON NDAJ ATIJ GJYQËSOR."

Kësaj ishte. Këtu fillon dhe mbaron drama. Dërmes se të bësh në filozofinë e Montesquieu-s, duhet të diësh të shkruash një titull. Por Ndreca nuk ka ardhur këtu në të mësuar shajn. Ai

ndrejtoni. Nuk merr asnjë mësim nga kjo. Sepse ai është njëri në mesin e Montesquieu, që shpesh të shprehë nga ai. Por ndreca nuk ka shprehur kurrë për të mos e shprehur. Në fakt, ka ardhur të shpëtojë Republikën. Me një fjali që të bën të kërkojë mësuesin e klasës së pestë.

Dhe çfarë republike do të shpëtojë Ndreca? Atë ku gjyqësori duhet të disiplinohet, por ai vetë nuk arrin të disiplinojë as pjesëmarrjen në seancat ku po gjykohet.

Ky është problemi i madh i këtyre njerëzve. Kur i shohin gjyqtarët dhe prokurorët, u dalin sytë përjashtë, u zgjatet gjuha dhe fillojnë të sillen si fëmijë që kanë parë një lodër të bukur në vitrinë. "Dua këtë! Dua atë! Pse nuk ma jepni?" Dhe kur nuk ua japin, shpikin një teori të re për rendin kushtetues.

Plarent Ndreca e ka shumë të lehtë të flasë për disiplinën e gjyqësorit. Në fakt është faji i gjyqësorit që ai mban akoma leksione dhe nuk ndodhet aty ku duhet. Megjithatë para se të disiplinojë gjyqtarët, të provojë një ushtrim të vogël me veten. Të shkojë në seancat ku po gjykohet ai. Të ulët në vendin e vet. Të dëgjojë çfarë thotë gjykata. Të përballet me çështjen e vet.

Pastaj, kur të ketë mbaruar ky ushtrim i thjeshtë, të ngrihet dhe t'i thotë Erion Veliajt të bëjë të njëjtën gjë.

Sepse është pak e çuditshme që një njeri që ka marrë përsipër të na shpjegojë si funksionon drejtësia, të mos e ketë kuptuar ende se seancat ku gjykohet vetë nuk janë një opsion dekorativ.

Por Plarent Ndreca nuk ndalet këtu. Ai na flet për "korporatizëm gjyqësor", "vetëgjyqësi institucionale", "vakum kushtetues" dhe "Republikë gjyqësore". Fjalë të mëdha, shumë të mëdha. Aq të mëdha sa duket sikur i ka marrë nga një fjalor dhe i ka hedhur në shkrim me shpresën se dikush do të mendojë se është i zgjuar.

Është ai lloji i fëmijës që ka mësuar tri fjalë të reja dhe i përdor në çdo fjali. "Mami, ku është buka? Sepse kemi një vakuum kushtetues në kuzhinë." "Babi, pse nuk më jep lekë? Sepse pushteti politik po abdikon ndaj atij gjyqësorë."

Dhe pastaj pret duartrokitje.

Të shkruash për Kushtetutën nuk të bën automatikisht zbatues të Kushtetutës. Të përmendësh Montesquieu-n nuk të bën Montesquieu. Dhe të përdorësh fjalën "disiplinë" njëzet herë nuk të bën njeri të disiplinuar.

Sidomos kur ke harruar se drejtësia fillon nga vetja.

Ndreca duhet të kuptojë një gjë të thjeshtë. Nuk mund të kërkojë disiplinë nga gjyqësori dhe të sillesh sikur rregullat janë bërë vetëm për të tjerët. Nuk mund t'u kërkojë gjyqtarëve të jenë të përgjegjshëm dhe pastaj të bësh sikur seancat e tua janë një detaj i parëndësishëm.


Dhe sa për shqipen, le ta lëmë Montesquieu-n të pushojë pak. Ai nuk ka faj që Ndreca e ka marrë në punë pa e pyetur fare.

Plarent, para se të shpëtosh Republikën, shpëto pak fjalinë. Para se të disiplinosh gjyqësorin, dispiplino veten. Dhe para se t'i japësh Veliajt leksione për seancat, shko njëherë në të tuat.

Se deri tani, i vetmi pushtet që duket se po abdikon është ai i trurit ndaj lapsit.

Me gjithë argumentet që ne sollëm, Plarent Ndreca duket se vazhdon të shkruajë me ChatGPT.

/CNA





Të sugjeruara

[“Puçi kushtetues i Kushtetueses”/ Gazetari: Puna e pagave të gjyqtarëve është palaçollëk](#)

[Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët përsërisin thirrjet kundër qeverisë](#)

[Reforma në Drejtësi "dështoi" kur u shkoi te dera 'Ndregrave'](#)

[“Bujqësia ka humbur mbi 300 milionë euro ndihma”/ Meta: Ky është shqetësimi i shqiptarëve, jo pagat e gjyqtarëve](#)

[Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?](#)

[Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë](#)

[E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi](#)

[Përplasja për pagat e magjistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën](#)

[Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin](#)

Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet

"Një situatë e tillë nuk është parë në botë"/ Pacolli: Aeroporti i Vlorës nuk duhet të mbetet peng i interesave të askujt

VIDEO/ Rrethohet Kryeministria, protestuesit zhvendosen në hyrjen e pasme të godinës

Zjarret dhe përmytjet në vend/ Ministria e Mbrojtjes përditësim për situatën

Deputeti i PD-së nën hetim nga SPAK/ Këllici: Interesi i Ramës kërkon përndjekje të opozitës

FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 105-të kundër qeverisë, mesazhet e diasporës

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 105 kundër qeverisë

Përplasjet për çështjen e pagave/ Gjyqtari Pëllumbi: SPAK mund të hetojë çdo person ndaj të cilit ka dyshime

105 ditë protestë kundër qeverisë/ Diaspora zbarkon në Tiranë

28 vjet nga vrasja e Azem Hajdarit/ Këllici: Vizioni dhe guximi e vendosën në krye të lëvizjes së dhjetorit


Çështja e pagave të drejtësisë/ Meta: Konflikti i provokuar nga Rama


[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM





Na ndiqni edhe në



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.